



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20 Ref.: 985/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2020 – 30 shtator 2023.
- II. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj që deri me datë 1 tetor 2020 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


**Arsyetimi**

I. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional. AKA ka organizuar vlerësimin me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional. Vlerësimi për riakreditim institucional është realizuar me 15.05.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Janez Vogrinc dhe Ketii Tsotniashvili.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vlerësimit, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsej njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj i plotëson plotësisht dy (2) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit), i plotëson substancialisht gjashtë (6) (Planifikimi strategjik; Mësimdhënia dhe të nxënit; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Burimet dhe hapësirat; Bashkëpunimi institucional), ndërsa plotëson pjesërisht tri (3) (Integriteti akademik; Menaxhimi i cilësisë dhe Hulumtimi).

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.



Prof. Dr. Gazmend Boteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.